



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **63**

Prishtinë, më 26.1.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Heset Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Dragiša Mirić, Zef morina, Selvie Halimi.

Mungoi : Ali Lajçi, Myrvete Pantina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtar dhe bashkëpunëtor ndërkombëtar (Iva Stamenova), përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku .

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 12.1.2010,
3. Institucionet dhe OJQ-të që mund të ofrojnë këshilltarët për komisionin,
4. Të ndryshme (plani i punës së Komisionit).

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës** për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 12.1.2010

Naser Rugova-kryetar konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 12.1.2010.

3. Institucionet dhe OJQ-të që mund të ofrojnë këshilltarët për komisionin

Naser Rugova falënderoi pjesëmarrësit dhe të ftuarit në pjesëmarrje, të cilët i njoftoi shkurtimisht për punën që e pret komisionin gjatë këtij viti. Ai shtoi se këtë komision gjatë këtij viti e presin sfida të ngjashme sikurse vitet e kaluara mirëpo ai theksoi se ligjet që parashihen për këtë vit të miratohen sipas strategjisë nga Qeveria kërkojnë një angazhim shumë korrekt ngase janë ligje që duhet të shqyrtohen pikërisht nga ekspertët që synon

komisioni t'i siguroi në punën e mëtejme. Fushat që i përfshin ky komision janë fusha shumë të rëndësishme edhe për komisionin evropian dhe shumë qartë shihet mungesa e ekspertëve në këto dy lëmi (mjedis dhe bujqësi). Pasi që tanimë komisioni ka adresuar institucionet ku mund të kërkohen ekspertët përkatës, ai falënderoi përfaqësuesit prezent të UNDP, KE, OSCE etj me të cilët kanë filluar kontaktet për realizimin e kërkesës së komisionit, për çka duhet të parashtrahet edhe kërkesa zyrtare nga ana e komisionit. Ai tha se komisioni i ka në agjendë 20 projektligje dhe bëhet fjalë për ligje bazike, ndaj është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e ekspertëve profesional në mënyrë që të ngritet cilësia e ligjeve që miratohen në Kuvendin e Kosovës.

Naim Maloku analizoi më detalisht ligjet për këtë vit dhe shtoi se ato të mjedisit kërkojnë ekspert nga ndërtimtaria dhe urbanizmi dhe propozoi që për secilin projektligj veç e veç të kërkohet ekspertiza (këshillimi me ekspert) kur të arrijnë në Kuvend në bashkëpunim me z. Zef Morina si më kompetent në këtë drejtim, ndërsa për ligje tjera sugjeroi që kryetari i komisionit të kontaktoi me z. Zeqir Veselaj (REC), Nexhat Jashari (GTZ) dhe Shkipe Deda, nëse ka nevojë të lidhë edhe ndonjë marrëveshje për bashkëpunim. Për projektligjet e fushës së bujqësisë gjithashtu propozoi të diskutohet atëherë kur të arrijnë në Kuvend veç e veç, ngase ligjet e propozuara nuk kanë lidhje mes vedit, ndaj kërkohet edhe këshilltari-eksperti të ndryshoi për çdo projekt.

Elheme Hetemi kërkoi sqarim nga z. Maloku a flet për ekspert të përhershëm apo sipas nevojës, në çka ai reagoi se duhet angazhim sipas nevojës.

Naser Rugova duke i cek ca shembuj të këshilltarëve nga SOROS-i dhe KFOS-i të cilët kanë dhënë këshilla-mendime tha se ato ndonjëherë mund të sjellin paqartësi në punën hulumtuuese në ndonjë projekt, ndaj sugjeroi që duhet të saktësohen qartë kërkesat e komisionit se çka kërkohet p.sh. në 6 mujorin e parë për hartimin e ligjeve cilësore, poçes komisioni evropian dërgon ekspert kjo do të ndikoi në ngritjen e cilësisë evropiane të ligjeve (si shembull mori projektligjin për pyje dhe paqartësitë gjatë shqyrtimit), sidomos duhet të publikohet për media puna e këtij komisioni ngase shpesh figuron një projekt që nuk është përfunduar në këtë komision, ndërsa në fakt shkaqet janë në mospunën e komisioneve tjera, ngase ky komision i kryen punët me rregull dhe ekzakt (si shembull e ceku projektligjin për shitjen e banesave). Ai konstatoi si përfundim personal : ekspertët duhet të japin mendimin p.sh. për 6 projektligje për të cilat edhe do të financohet.

Berat Luzha propozoi të kontaktohet eksperti mjedisor Shyqyri Dumani në Kastriot i cili do të ishte shumë i dobishëm për komisionin.

Naser Rugova sugjeroi që të kontaktohen rregullisht zyrtarët e dy ministrive përkatëse (p.sh. çdo 3 muaj) nga të cilët ky komision duhet të pranoj njoftime zyrtare të nënshkruara nga ministri dhe të dërgohen pastaj në komisionin për integritet evropian, njëherit këto dy ministri do të raportojnë edhe këtij komisioni në afatin e njëjtë kohor, ngase në agjendë Kosova mund të konkurroi me këto dy fusha, ndaj është shumë me rëndësi të kemi mbështetjen e ekspertëve.

Blerim Vela nga OSCE insistoi se Bordi për mjedis sipas Ligjit për Mjedis duhet me këshillua kuvendin p.sh. si bëhen raportet e VSM-së dhe kur bëhen , ngase (u bashkëngjit **Naser Rugova**) asnjë projekt kapital nuk mund të bëhet pa standarde dhe pa respektuar procedurat e parapara, për shkak se formohen diskrepanca të mëdha ndërmjet ministrive nga të cilët propozohen ligjet.

Selvie Halimi sugjeroi që kërkesa për ekspert duhet të drejtohet edhe tek fakultetet tona përkatëse për profesorë të lëmisë së kërkuar. **Naim Maloku** sugjeroi që kjo pikë të përfundoi me një përfundim zyrtarë duke hartuar kërkesën konkrete, ndërsa kryetari me pajtimin e komisionit nxori :

P Ë R F U N D I M

Të hartohet nga komisioni kërkesa zyrtare për ekspert, e cila do t'i drejtohet dy institucioneve ndërkombëtare (UNDP dhe Komisionit Evropian) të cilët do të angazhohen sipas sugjerimeve të komisionit që u diskutuan në mbledhjen e sotme (ekspert për projektligje të caktuara).

4. Të ndryshme

Plani i punës së komisionit për vitin 2010

Naser Rugova kërkoi që ky plan të shqyrtohet sot ngase kështu është kërkuar nga kryesia e Kuvendit, ndaj propozoi draftin e punuar bashkërisht me stafin dhe menjëherë në fillim propozoi që të përfshihet në këtë plan ftesa për dy ministrat rreth raportit të progresit. Ai në vazhdim bëri edhe analizën tabelore të propozuar të veprimeve që duhet të ndërmarr komisioni, për çka shprehu disa mospajtime me strategjinë e propozuar nga Qeveria.

Elheme Hetemi tha se ligji për pyje ose ndonjë tjetër, mund të hartohet edhe nga vet komisioni, pasi që ministria do të vonohet për ligjin në fjalë. **Zef Morina** tha se ky fakt është i qartë por si të hartohet dhe a kemi mundësi.

Naim Maloku konstatoi se një projekt që parashihet për 1.12.2010 lirisht mund të thuhet se nuk i takon këtij viti, ngase teknikisht është e pamundur kjo.

Për vizita jashtë shtetit Naser Rugova tha që Kroacia dhe Sllovenia (për muajin Prill) të zëvendësohet me Malin e Zi për shkak se ky shtet ka parapa strategjinë ekologjike, ndaj mund të shihet se sa ka ndikua kjo strategji në legjislacionin Malazez në mënyrë që të zbatohet pastaj edhe te ne. Gjatë muajit prill mund të parashihet edhe një vizitë në Maqedoni edhe në ESTONI (muaji maj). **Berat Luzha** tha se deputetët Maqedon nuk kanë pranuar mu takua me deputetët Kosovar në vizitën e fundit. Reagimi ishte se atëherë ende nuk ishte njohur Kosova nga Maqedonia.

Gjatë **muajit mars** të parashihet një ftesë për komisionin homolog në Shqipëri përmes ambasadës në Prishtinë.

Në tremujorin e parë të **kërkohet zyrtarisht** nga zyra e KE (përmes përfaqësueses **Iva Stamenova**) mbështetje financiare për një vizitë studimore komplete të komisionit në Bruksel (dy-ditëshe), dhe të kërkohen edhe donator tjerë nëse ka nevojë. **Zylfi Merxha** kërkoi sqarim pse vizitë studimore dyditëshe (duke aluduar se janë pak). Kryeatri sqaroi se gjatë udhëtimeve zyrtare cekën vetëm ditët e punës në shtetin e cila vizitohet.

Një **debat publik** për mbrojtjen e mjedisit dhe të pyjeve të mbahet në intervalin kohor kur komisioni nuk ka aktivitete të dendura ose çdo tre muaj të mbahen nga një debat publik.

Të organizohet **debati rreth kontrollit** të zbatimit të rekomandimeve për monitorimin e Ligjit për Mbeturina (**Elheme Hetemi**).

Të shpejtohet arritja e projektligjeve në Kuvend në 6 mujorin e parë, dhe të mbahet një takim me dy ministrat lidhur me këtë çështje (**Selvie Halimi**).

Të **monitorohet** zbatimi i Ligjit për Tokat Bujqësore (muaji qershor).

Dëgjim publik për **gjendjen e ujërave** në Kosovë (muaji shtator).

Të procedohen projektligjet gjatë muajve nëntor dhe dhjetor.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Mbledhja e radhës së Komisionit mbahet më 9 shkurt 2010 në orën 13,00 duke ftuar ministrin e Bujqësisë dhe të Mjedisit të cilët do të raportojnë për raportin e progresit Evropian dhe projektligjet e propozuara në strategjinë legjislative, ndërsa pika tjetër do të jetë Pasqyra e ligjeve të Kuvendit të Kosovës që zbatohen në praktikë, e përgatitur nga OSCE (sa jap rezultat kjo praktikë).

2. Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguri nukleare procedohet për leximin e dytë, pasi që ka përfundua shqyrtimi në komisionet kryesore.
3. **MIRATOHET** Plani i punës së Komisionit për vitin 2010 i cili do të plotësohet nga stafi sipas vërejtjeve të lartcekura dhe do të dorëzohet në zyrën e parashtrësave të Kuvendit deri më **29.1.2010**.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,15. Mbledhja e radhës do të mbahet më 9.2.2010.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova